



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-151

Prishtinë, më 31 mars 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 31 MARS 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sreten Ivanoviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 17 dhe 24 mars 2014,
2. Vazhdimi i seancës plenare, të filluar më 27 mars 2014,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 17 dhe 24 mars 2014

Kryesia i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 17 dhe 24 mars 2014, me vërejtjen e nënkryetarit të Kuvendit, Sabri Hamiti, për një lëshim teknik në evidencimin e mbiemrit të tij. Procesverbalet janë korrigjuar sipas vërejtjes.

2. Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 27 mars 2014

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e papërfunduara të seancës së mëparshme, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të enjten, më 3 prill 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

7. *Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013,*
8. *Votimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013,*
9. *Votimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ripranim,*
10. *Votimi i deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe Shoqërisë Civile dhe*
11. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.*

Për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës së seancës plenare - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, diskutuan: Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti, Petar Miletiq dhe Ardian Gjini, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 3 prill 2014, në orën 12:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,*
- 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale.*

4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

- 1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit*

Kryesia, pas diskutimit lidhur me projektligjin e lartpërmendur, nxori këtë:

P e r f u n d i m

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e duhanit, i propozuar nga 10 mijë qytetarë, t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision Funkcional që në konsultim me përfaqësuesin e propozuesit dhe të Qeverisë së Kosovës ta shqyrtojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin e duhanit dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

2. Rekomandimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me funksionimin e agjencive dhe rregullatorëve të pavarur që i raportojnë Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pas diskutimit lidhur me rekomandimin e lartpërmendur, nxori këtë:

P e r f u n d i m

1. Rekomandimet e Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me funksionimin e agjencive dhe rregullatorëve të pavarur që i raportojnë Kuvendit para se të procedohen në Kuvend t'u dërgohen për shqyrtim komisioneve parlamentare.

2. Ngarkohen komisionet parlamentare që deri më 14 prill 2014 t'i shqyrtojnë rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me funksionimin e agjencive dhe rregullatorëve të pavarur dhe Kuvendit t'ia paraqesin rekomandimet e tyre.

3. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për delegacionin e Kuvendit të Shqipërisë, që do ta vizitojë Kuvendin e Kosovës më 3-5 prill 2014

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës në Kosovë të delegacionit të udhëhequr nga kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, prej datës 3-5 prill 2014.

2. Të gjitha shpenzimet e dala me rastin e pritjes së delegacionit të udhëhequr nga kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, duke përfshirë akomodimin dhe ushqimin, si dhe shpenzimet tjera të nevojshme mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me procedimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës

Për njoftimin e lartpërmendur diskutoi Jakup Krasniqi, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimit lidhur me njoftimin e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohej nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që ta rishqyrtojë rekomandimin për propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës lidhur me rezultatin e votimit, datë 4 mars 2014, dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*